Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01 - 603
Datë: 13.10.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023 nxjerr këtë:

VENDIM

I. Akreditohet Institucioni Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim "Nënë Terezë" me adresë: në Prizren, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 05.10.2023 deri 04.10.2026, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar kursin:

1.1 Gjuha e Shenjave në Kosovë si Gjuhë e Dytë për Nivelet A1, A2 – B1, B2
Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga një (1) grup për secilin nivel, me dymbëdhjetë (12) pjesëmarrës në grup.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Institucioni Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim "Nënë Terezë" me adresë në Prizren ka parashtruar kërkesë në AKK, për Akreditim të institucionit për ofrimin e kursit Gjuha e Shenjave për nivelet A1, A2 dhe B1, B2 sipas KKK. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Pas realizimit të vizitës nga ekipi i ekspertëve në këtë institucion dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipi i ekspertëve në raportin përfundimtar të hartuar me datë 02.06.2023 ka dhënë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si

institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe certifikues i kursit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.
Andaj, në bazë të kërkesës për akreditim të Institucionit Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim "Nënë Terezë", Prizren si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhënë në Raportin e vlerësimit për akreditim për këtë institucion, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij vendimi i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:
1.IAP-Qendra Burimore për mësim dhe Këshillim " Nënë Terezë"
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK